

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Po cenohet pavarësia e gjyqësorit"/ Shoqata e Gjyqtarëve mbron Ramiz Lalën: Liria e medias nuk mund të shndërrohet në instrumente të denigrimit dhe sulmit personal
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/po-cenohet-pavaresia-e-gjyqesorit-shoqata-e-gjyqtareve-mbron-ramiz-la-i513966
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:06:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6b5b6f488b55982370460f227000f0391a7ca9ebdde5a57b574c9364fe54e796
TEKSTI	1a2637d3c59933cdfaef58719033fd8c18a2e975a5d66a24190cd09c0cdb7602
PAMJA	db77b0dfdd796be8ac12a73044c123d90441314c1adbfb786fc287d2732720d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b3360b42252da36ede1ec44c6047761b67888e8b85cb95b7a907c84dc309e99f
E MËPARSHMJA	e9b36a37d5c9c0220606f88149df7b7333b816d624bce536b00647989558a2b4
RRËNJA MERKLE	5a17c12c14e78c5a4225635ca4dd5bf0de00406a8b7800bc862a616c14968175
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/b3360b42252da36ede1ec44c6047761b67888e8b85cb95b7a907c84dc309e99f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

4 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

5 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

10 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

11 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

Aktualitet

"Po cenohet pavarësia e gjyqësorit"/ Shoqata e Gjyqtarëve mbron Ramiz Lalën: Liria e medias nuk mund të shndërrohet në instrumente të denigrimit dhe sulmit personal

Kjo duke pretenduar se në to janë përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe akuza të rënda ndaj integritetit të tij.



13 Shtator 2026, 21:40
Nga E.d



Foto ilustruese

TIRANA- Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve ka reaguar lidhur me publikimin e disa artikujve në media, të cilët sipas tyre kishin në fokus gjyqtarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Ramiz Lala. Përmes një deklarate zyrtare, ata i kanë cilësuar shkrimet e publikuara në media si sulm të papranueshëm ndaj gjyqtarit. Kjo duke pretenduar se në to janë përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe akuza të rënda ndaj integritetit të tij.

Shoqata thekson se liria e shprehjes dhe e medias nuk mund të shndërrohen në instrumente të denigrimit dhe sulmit personal ndaj gjyqtarëve, në mjete për t'i akuzuar ata për veprimtari kriminale, pa asnjë vendimarrje të organeve kompetente.

Shoqata e konsideron shqetësues faktin se ky sulm personal publik është kryer menjëherë pasi gjyqtari Ramiz Lala ka dhënë vendimin e parë gjyqësor lidhur me një prej padive të paraqitura nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, që synon zhbllokimin e situatës të mospagimit të pagave ndaj magistratëve dhe administratës gjyqësore.

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve përsërit se solidarizohet dhe shpreh mbështetjen e saj të palëkundur për gjyqtarin Ramiz Lala përballë çdo forme sulmi personal, që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 22:43

Dita e 45-së e protestës/
Divjaka kundër shkrirjes me
Lushnjen: Do t'a fitojnë këtë
betejë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 20:34

FOTOLAJM/ Pankartat
pikante nga dita e 106-të e
protestës qytetare në Tiranë

Deklarata

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë shpreh shqetësimin e saj të thellë për disa nga artikujt e publikuar në median e shkruar dhe digjitale më datë 11 shtator 2026, disa prej tyre të fshirë ditën e sotme, në të cilët gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, z. Ramiz Lala, është bërë objekt i një sulmi të paprecedentë e të papranueshëm, nëpërmjet përdorimit të një gjuhe denigruese, fyese dhe akuzave të pabazuara e jashtëzakonisht të rënda ndaj figurës dhe integritetit të tij si magjistrat, menjëherë pas dhënies së vendimit lidhur me kërkesën e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për sigurimin e padisë për mosekzekutimin e pagave të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, sipas urdhërpagesave të dërguara prej kësaj të fundit.

Së pari, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve shpreh mbështetjen e saj të palëkundur për gjyqtarin Ramiz Lala, i cili ka shfaqur cilësitë dhe vlerat më të larta të një magjistrati ndër vite, përmes vendimeve të tij, në përbushje të funksionit të tij kushtetues.

Së dyti, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve garanton përkushtimin e saj ndaj respektimit të lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe të drejtës së gazetarëve për të informuar publikun, për të përbushur misionin e tyre investigativ dhe për të mbajtur qëndrim kritik dhe objektiv mbi veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë edhe vendimet gjyqësore, si një aktor i pazëvendësueshëm në garantimin e shtetit të së drejtës.

Megjithatë, liria e shprehjes dhe e medias nuk mund të shndërrohen në instrumente të denigrimit dhe sulmit personal ndaj gjyqtarëve dhe, aq më pak, në mjete për t'i akuzuar ata për veprimtari kriminale, pa asnjë vendimmarje të organeve kompetente dhe jashtë çdo procesi të rregullt ligjor, veçanërisht kur vetë këto media nuk kanë përdorur asnjë prej mjeteve procedurale në dispozicion për të kallëzuar të dhënat e referuara prej tyre si të vërteta. Shoqata sjell në vëmendje të mediave se, ndryshe nga opinionet dhe vlerësimet kritike që përbajnë qasjet personale të gazetarëve, publikimet apo shkrimet që parashtrojnë të dhëna si fakte duhet të verifikojnë paraprakisht vërtetësinë e tyre, së paku deri në një nivel të arsyeshëm, pasi, në të kundërt, rrezikojnë të cenojnë kufirin e lirisë së shprehjes dhe të shtypit, të garantuar nga neni 22 i Kushtetutës dhe neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Thënë këtë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve vëren se artikujt në fjalë nuk përbajnë thjesht kritikë ndaj vendimit gjyqësor të marrë nga gjyqtari Ramiz Lala, por, përmes përdorimit të shprehjeve të patoluerueshme fyese dhe denigruese, përbëjnë një sulm të drejtpërdrejtë personal ndaj integritetit dhe pastërtisë së figurës së tij, në një kohë që këta elementë, si dhe kompetenca e tij profesionale, janë konfirmuar në përfundim të procesit të vetting-ut me vendimin nr. 18, datë 12.07.2021, të Komisionit të Posaçëm të Apelimit. Paraqitja e akuzave të kësaj natyre si fakte të mirëqena, në kundërshtim me atë çfarë është vendosur nga Komisioni i Posaçëm i Apelimit, tejkalon dukshëm kufijtë e kritikës së ligjshme ndaj veprimtarisë së një gjyqtari dhe dezinformon publikun, duke rënë kështu ndesh me misionin e medias.

Shoqata e konsideron veçanërisht shqetësues faktin se ky sulm personal publik është kryer jo vetëm në kushtet e një debati të tensionuar publik, por menjëherë pasi gjyqtari Ramiz Lala ka dhënë vendimin e parë gjyqësor lidhur me një prej padive të paraqitura nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, që synon zhblokimin e situatës së paprecedentë të mospagimit të pagave ndaj magjistratëve dhe administratës gjyqësore.

Kjo situatë krijon një klimë të rrezikshme presioni mbi pushtetin gjyqësor dhe gjyqtarët që pritet të gjykojnë kërkesat e tjera për sigurim padie të së njëjtës natyrë.

Sulmi ndaj dinjitetit dhe integritetit të një gjyqtari për shkak të një vendimi të dhënë prej tij nuk prek vetëm individin. Ai cenon besimin të drejtësisë dhe krijon presion mbi pushtetin gjyqësor dhe, për pasojë, artikuj të tillë përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për pavarësinë e tij. Pavarësia e sistemit gjyqësor nuk është privilegj personal i gjyqtarit, por garanci e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarit. Ajo është garanci për qytetarin se çështja e tij do të zgjidhet vetëm mbi bazën e Kushtetutës dhe ligjit, me paanshmëri dhe pa u ndikuar nga pushtetet e tjera apo faktorët mediatikë.

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve përsërit se solidarizohet dhe shpreh mbështetjen e saj të palëkundur për gjyqtarin Ramiz Lala përballë çdo forme sulmi personal, që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues. Në të njëjtën kohë, u bën thirrje të gjitha mediave dhe aktorëve publikë që debatin mbi vendimet gjyqësore ta zhvillojnë me përgjegjësi, profesionalizëm dhe në respektim të parimeve të shtetit të së drejtës, duke respektuar kufijtë të cilëve u nënshtrohet liria e shprehjes dhe liria e medias, përkatësisht, respektimin e dinjitetit të individit dhe mosndërhyrjen në pavarësinë e gjyqësorit.

Shoqata do të monitorojë me vëmendje çdo rast në të cilin gjyqtarët bëhen objekt i sulmeve, kërcënimeve, denigrimit apo presionit për shkak të vendimeve të tyre dhe, kur rrethanat e kërkojnë, do të vlerësojë përdorimin e çdo mjeti institucional dhe ligjor të parashikuar nga legjislacioni në fuqi./Dosja.al

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë

më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplaslet me banorët e Policantit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga "Taken" te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Zgjedhjet në Suedi/ E djathta ekstreme synon pushtetin për herë të parë

insights

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi
REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by  tomorrow.

Deklaratë e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve për gjuhën intimiduese nga media e shkruar ndaj gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë Z. Ramiz Lala lidhur me vendimmarrjen gjyqësore.

Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë
në min e saj të thellë për disa nga artikujt e publikuar në të
dijigjiale në datën 11 shtator 2020, disa prej tyre të fashit
së të cilët Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës
Z. Ramiz Lala, është bërë objekt i një sulmi të paprecedent
ieshëm, nëpërmjet përdorimit të një gjuhe denigruese, f
të pabaza e jashtëzakonisht të rënda ndaj figurës dhe int
magjistrat, menjëherë pas dhënies së vendimit lidhur me k
tës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organi
in e padisë për moszekutimin e pagave të gjyqtar
tratis gjyqësore sipas urdhërpagesave të dërguara prej

Thënë kështu, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve vëren se artikujt në fjalë
nuk përmbajnë theks kritikë ndaj vendimit gjyqësor të marrë nga
gjyqtari Ramiz Lala, por, përmasë përdorimit të shprehjeve të
intimiduese kryer dhe denigruese, përbejnë një sulm të drejtpërdrejt
personal ndaj integritetit dhe pastërtisë së figurës së tij, në një kohë që
kjo elementë, si dhe kompetenca e tij profesionale janë konfirmuar në
shënimin të procesit të votës-sat me vendimin nr.18, datë 12.07.2021 të
Komisionit të Posaçëm të Apelit. Parajftja e akuzave të këtuaj natyre s
është të mirëqena, në kundërtim me atë çfarë është vendosur nga
Komisioni i Posaçëm i Apelit, ngjashmë dukshëm kufijtë e kritikës si
ngjashmë ndaj veprimtarisë së një gjyqtari dhe dezinformon publikun
kërkë ethe këtuja ndesh me misionin e medias.

Shoqata e konsideron veçanërisht shqetësues faktin se ky sulm personal
nëlik është kryer jo vetëm në kushtet e një debati të tensionuar publik
por menjëherë pasi Gjyqtari Ramiz Lala ka dhënë vendimin e parë
gjyqësor lidhur me një prej padive të parajftuara nga gjyqtari i Republikës
së Shqipërisë, që synon zhbllokimin e situatës së paprecedentit të
nospajimit të pagave ndaj magistratëve dhe administratës gjyqësore
kjo situatë krijon një klimë të rrezikshme presioni mbi pushtetin gjyqësor
dhe gjyqtarë që përjet të gjykojnë kërkuesit e tjera për sigurinë publike të s
njëjtës natyre.

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve shpreh mbështetjen
dhe për Gjyqtarin Ramiz Lala, i cili ka shfaqur cilësitë d
arta të një magjistrati ndër vite përmes vendimeve të
shije të funksionit të tij kushtetues.

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve garanton përkushtimin
holmi ndaj drejtësisë dhe integritetit të një gjyqtari për shkak të një
ordani të dhënë prej tij nuk prek vetëm individin. Ai cemon besimin të
prezantit të lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe të d
ive për të informuar publikun, për të përmbushur misionin
ativ dhe për të mbajtur qëndrim kritik dhe objekt
aritetit të se drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarit. Ajo është
parancë për qytetarin se çështja e tij do të zgjidhet vetëm mbi bazën e
Caktimit dhe ligjit, me paanshëritë dhe jo u ndikuar nga pushteti e
jera apo faktori mediatik.

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve përcëft se soliditeti dhe shpreh
nëbërjeten e saj të palikundur për Gjyqtarin Ramiz Lala përballë çd
seme sulmi personal, që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues
të si njëjtës kohë, u bëu fjalë se gjitha mediave dhe aktorëve publikë
në debatin mbi vendimet gjyqësore ta zhvillojnë me përgjegjësi
profesionalizëm dhe në respektim të parimeve të shtetit të së drejtës, duke
respektuar kufijtë të cilëve u nënshtrohet liria e shprehjes dhe liria e
medias, përkushtet, respektimi i drejtësisë të individit dhe mosndërrje
si pavarësinë e gjyqësorit.

Shoqata do të monitorojë me vëmendje çdo rast në të cilin gjyqtarët bëhen
objekt i sulmeve, kërcënimeve, denigrit apo presioni për shkak të
vendimeve të tyre dhe, kur rrethanat e kërkojnë, do të vlerësojë

Shoqata do të monitorojë me vëmendje çdo rast në të cilin gjyqtarët bëhen
objekt i sulmeve, kërcënimeve, denigrit apo presioni për shkak të
vendimeve të tyre dhe, kur rrethanat e kërkojnë, do të vlerësojë

👍 35 💬 Komento ➡ 7

shoqata kombëtare e gjyqtarëve

ramiz lala

deklarate

Sondazh

Poll

Aktualitet

13 Shtator 2020, 21:14

Dita e 106-të e protestës/ Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, qytetarët nisin marshimin

Pamje TIRANA- Protestuesit kanë mbyllur fjalimet para Kryeministrit. Nën thirrjet "Nesër më shumë" dhe "Ju erdhi fundi" ...

"Ndryshimi po vjen, diaspora ka ardhur"/ Qytetari: Kjo është java e mosbindjes civile, pushteti nuk mund të jetë mbi popullin

Aktualitet

13 Shtator 2020, 21:04

Viti i ri shkollor/ Profesori Lush Susaj:
Mësues, mësojuni nxënësve të mos
heshtin

Aktualitet

13 Shtator 2026, 20:54

"Mërgata të na bashkohet, ndryshe
Atdheu do të ngelet pa shqiptarë"/
Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja
në sheshin "Skënderbej" nis në orën 18:30

Aktualitet

13 Shtator 2026, 20:43

FOTOLAJM/ Pankartat pikante nga dita
e 106-të e protestës qytetare në Tiranë

Aktualitet

13 Shtator 2026, 20:34

Aktualitet

13 Shtator 2026, 20:15

**"Ramës i kanë dalë kundër edhe deputetët e
tij"/Aktivisti: Nuk dorëzohemi pa u mbytur varka e
qeverisë!**

Mirjan Aliaj TIRANA- Aktivisti Mirjan Aliaj ishte një nga folësit në
protestën e ditës së sotme, e cila po zhvillohet pa...

Përplasjet e Ramës me banorët e
Poliçanit, qytetari: U soll si sulltan, u tha
qepenit gojën

Aktualitet

13 Shtator 2026, 20:01

"Revolucioni i Flamingove" është

shnderruar ne nje mobilizim te
qendrueshem"/ TV francez "C News":
Rama misheron establishmentin

Aktualitet

13 Shator 2026, 19:45

Dita e 106-të e protestës/ Nis marshimi
drejt Kryeministrit: Shqipëria kërkon
revolucion

Aktualitet

13 Shator 2026, 19:35

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.